



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 827/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shpresa (Azemi) Shemsedini kandidate për asamble komunale nga radhët e subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionerit Ismajl Ramadani Komuna e Ferizajit, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Shpresa (Azemi) Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12.11.2013, nga Shpresa (Azemi) Shemsedini për arsye të manipulimit të votave mbrenda subjektit politik.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Me nenin 118.4 LZP-së parshihet se “ Mund të apelohej vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.

Pretendimet ankimore nga Shpresa (Azemi) Shemsedini kandidate për anëtare të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik PDK –së, dega në Ferizaj se janë bërë shkeljet e theksuara, janë të pabazuara, nga shkakut se nuk janë bashkangjitur asnjë provë shtesë apo dëshmi bindesë ankesës së parashtruar me të cilat do të administrohej lënda, ose do të mund të vërtetohej vërtetësia e shkeljes së pretenduar.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartëpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 827/2013 më datën 12.11.2013



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda njëzetekatër (orë)orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.